

MUNDËSITË E RRJETËZIMIT PËR bizneset e grave dhe pakicave etnike në Kosovë



Mundësitë e rrjetëzimi për bizneset e grave dhe pakicave etnike në Kosovë

Tetor 2024

Deklaratë mohimi:

"Ky raport u mundësua me mbështetjen e Popullit Amerikan përmes Agjencisë së Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID). Përmbajtja e raportit mbetet përgjegjësi vetëm e Institutit GAP dhe nuk pasqyron domosdoshmërisht pikëpamjet e USAID-it ose Qeverisë së Shteteve të Bashkuara."

Ky raport është shkruar fillimisht në gjuhën angleze.

— Përmbajtja

Përmbledhje ekzekutive	4
Metodologjia	5
1. Roli i rrjetëzimit për bizneset në pronësi të grave dhe ato në pronësi të pakicave etnike	6
2. Praktikrat ndërkombëtare dhe rajonale të rrjetëzimit për NMVM-të	7
3. Praktikrat e rrjetëzimit në Kosovë	9
3.1. Analizë e odave ekonomike dhe shoqatave të biznesit në Kosovë	9
3.2. Nevojat për rrjetëzimin e bizneseve në pronësi të grave: Analiza e gjetjeve nga intervistat me biznese mikro dhe të vogla në pronësi të grave dhe ato në pronësi pakicave etnike	10
3.3. Mundësitë e rrjetëzimit për bizneset në pronësi të grave dhe ato në pronësi të pakicave etnike: Analiza e gjetjeve nga intervistat me odat ekonomike dhe shoqatat e biznesit	12
4. Analiza e anëtarësisë sipas gjinisë	12
5. Tarifat e anëtarësisë dhe mundësitë që ofrohen	14
6. Përfundim dhe rekomandime	15
7. Shtojcë	16

Pasqyra e shkurtesave dhe shkurtimeve

AmCham	Oda Ekonomike Amerikane në Kosovë
ARBK	Agjencia e Regjistrimit të Bizneseve në Kosovë
BERZh	Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim
CEED	Qendra për Ndërmarrësi dhe Zhvillim Ekzekutiv
ESNAF	Shoqata e Bizneseve dhe Artizanatit
FMN	Fondi Monetar Ndërkombëtar
G7	Dhoma Ekonomike e Grave të Kosovës
IEEA	Aktiviteti i USAID-it Angazhimi Gjithëpërfshirës Ekonomik
OEGJK	Oda Ekonomike Gjermano-Kosovare
OEKI	Oda Ekonomike Kosovë-Izrael
KIESA	Agjencia për Investime dhe Përkrahjen e Ndërmarrjeve në Kosovë
OEKZ	Oda Ekonomike Kosovë-Zvicër
OEKT	Oda Ekonomike Kosovë-Turqi
NMVM	Ndërmarrje Mikro, të Vogla dhe të Mesme
OEK	Oda Ekonomike e Kosovës
OJQ	Organizatë Jo-Qeveritare
Organika	Shoqata e Bizneseve për produktet pyjore jo-drusore dhe bimët mjekësore dhe aromatike
PePeKo	Shoqata e Përpunuesve të Pemëve dhe Perimeve në Kosovë
STIKK	Shoqata për Teknologji të Informacionit dhe Komunikimit në Kosovë
USAID	Agjencia e Shteteve të Bashkuara për Zhvillimin Ndërkombëtar

Përmbledhje ekzekutive

Bizneset në pronësi të grave dhe në pronësi të pakicave etnike në Kosovë shpesh operojnë në shkallë më të vogël dhe përballen me barriera të shumta si konkurrenca e padrejtë, mangësitë e digjitalizimit dhe tronditjet ekonomike. Këto çështje çojnë në produktivitet më të ulët të punës, kufizime financiare, qasje të kufizuara në kapital dhe trajnime për aftësim, duke penguar kështu rritjen e tyre.

Ndërkohë, studimet globale nxjerrin në pah vlerën e mundësive të rrjetëzimit për qëndrueshmërinë dhe rritjen e ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme (NMVM), pasi ato lehtësojnë lidhjet me klientët, furnizuesit dhe partnerët e mundshëm. Për më tepër, provat sugjerojnë se mundësitë e rrjetëzimit rrisin qasjen e NMVM-ve në mundësi financimi siç janë grantet dhe subvencionet, asistencë teknike, por edhe ndërgjegjësimin për trendet aktuale në treg. Për këtë arsye, ky raport shqyrton praktikën e rrjetëzimit të bizneseve mikro dhe të vogla në pronësi të grave dhe ato në pronësi të pakicave etnike në Kosovë, duke nxjerrë njohuri nga intervistat me pronaret/ët e këtyre bizneseve dhe analizat e odave ekonomike dhe shoqatave të biznesit.

Gjetjet e intervistave sugjerojnë se shumica e bizneseve në pronësi të grave dhe ato në pronësi të pakicave etnike në Kosovë e njohin rëndësinë e angazhimit në aktivitete rrjetëzimi për qëllime të veprimtarisë afariste dhe rritjes së biznesit. Shumë nga këto biznese janë të lidhura me shoqata të ndryshme biznesi, si odat ekonomike dhe shoqatat e grave. Megjithatë, tarifat e larta të anëtarësisë përbëjnë pengesë të theksuar, veçanërisht për mikro-bizneset. Pavarësisht vullnetit për të marrë pjesë, kostoja pengon disa nga këto biznese në pronësi të grave dhe në pronësi të pakicave etnike që të anëtarësohen. Ndërsa për ato biznese që nuk janë të angazhuara në shoqata biznesi, mungesa e ndërgjegjësimit për përfitimet nga anëtarësia rezultoi të ishte po ashtu pengesë.

Megjithatë, bizneset që investojnë në nivele më të larta anëtarësie raportojnë përfitime të konsiderueshme, veçanërisht në rrjetëzim dhe në ndërtimin e marrëdhënieve. Pavarësisht përpjekjeve për të promovuar përfshirjen gjinore, bizneset në pronësi të grave mbeten të nën-përfaqësuara në rrjetet e biznesit, duke përbërë më pak se 10% të anëtarëve në odat ekonomike, me përjashtim të Odës Ekonomike të Grave në Kosovë (G7 Kosova), dhe më pak se 20% në shoqatat e tjera të biznesit, me përjashtim të Shoqatës së Përpunuesve të Pemëve dhe Perimeve në Kosovë (PePeKo) dhe Shoqatës së Bizneseve për produkte pyjore jo-drusore dhe bimë mjekësore dhe aromatike (Organika). Ato që janë anëtare janë të përqendruara kryesisht në sektorë të tillë si tregtia me shumicë dhe pakicë, prodhimi dhe aktivitetet e shërbimit.

Tarifa mesatare vjetore e anëtarësisë është 1,233 euro për odat ekonomike dhe 368 euro për shoqatat e tjera të biznesit. Këto tarifa janë të larta për shumë biznese mikro dhe të vogla në pronësi të grave dhe në pronësi të pakicave etnike, duke penguar që ato të kenë qasje në mundësi të vlefshme rrjetëzimi. Përveç kësaj, kriteret e rrepta të vendosura nga Agjencia Kosovare për Investime dhe Përkrahjen e Ndërmarrjeve në Kosovë (KIESA), siç janë kërkesat e larta të qarkullimit vjetor, përjashtojnë shumë biznese në pronësi të grave nga pjesëmarrja në panairë ndërkombëtare.

Për të adresuar këto sfida, Instituti GAP rekomandon që Qeveria e Kosovës dhe donatorët ndërkombëtarë dhe vendorë të subvencionojnë tarifat e anëtarësisë për bizneset në pronësi të grave dhe të pakicave etnike. Implementimi i masave afirmative për të mbështetur këto biznese do të rriste pjesëmarrjen e tyre në shoqatat e biznesit dhe do të siguronte mundësi më përfshirëse për rrjetëzim. Po ashtu, rekomandimet për palët e interesit sugjerojnë rëndësinë e organizimit të panairëve dhe ngjarjeve si takimet "Biznes-me-Biznes" (B2B) për bizneset në pronësi të grave dhe të pakicave etnike për të promovuar një mjedis biznesi më përfshirës, më novator dhe më të qëndrueshëm.

Metodologjia

Ky raport analizon mundësitë e ofruara nga odat ekonomike dhe shoqatat e biznesit në Kosovë për ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme (NMVM) në pronësi të grave dhe të pakicave etnike, së bashku me të dhënat sasiore dhe demografike të anëtarësisë dhe tarifave përkatëse.

Ky studim përdori qasje kërkimore me metoda të përziera, duke përfshirë një rishikim të literaturës ekzistuese, analizën e të dhënave institucionale dhe intervista. Rishikimi dokumentar përfshinë rishikimin e literaturës së praktikave më të mira ndërkombëtare, analizën e kornizës ligjore të Kosovës që rregullon odat ekonomike dhe shoqatat e biznesit, dhe mbledhjen e të dhënave dytësore publike në dispozicion nga uebfaqet e odave ekonomike dhe shoqatave të biznesit që veprojnë në Kosovë.

Të dhënat parësore u mbledhën përmes intervistave të kryera me përfaqësues nga odat ekonomike dhe shoqatat e përmendura në raport, si dhe përmes intervistave me 16 biznese mikro dhe të vogla në pronësi të grave dhe pesë në pronësi të pakicave etnike. Bizneset në pronësi të pakicave etnike që u intervistuan përfshijnë individë të komunitetit rom, turk dhe serb. Për përzgjedhjen e bizneseve për të marrë pjesë në intervista, u përdor një qasje e përzgjedhjes së përshtatshme. Kjo do të thotë se bizneset janë përzgjedhur në bazë të anëtarësisë së tyre në rrjete të ndryshme biznesi si odat ekonomike apo shoqatat, disponueshmëria dhe gatishmëria për pjesëmarrje, dhe jo përmes përzgjedhjes së rastësishme ose metodave të tjera të përzgjedhjes së bazuar në probabilitet. Kjo qasje u çmua e përshtatshme duke pasur parasysh natyrën eksploruese të studimit. Nga bizneset e intervistuar, 14 ishin anëtarë aktualë të rrjeteve të biznesit (oda ekonomike apo shoqata biznesi), ndërsa shtatë nuk kishin qenë asnjëherë anëtarë të asnjë shoqate biznesi. Këto biznese u përfshinë nënkas në studim për të fituar njohuri mbi arsyet e mos-anëtarësisë së tyre.

Shumica e bizneseve të intervistuar operojnë në sektorë të tillë si prodhimi, tregtia me shumicë dhe pakicë, aktivitetet e shërbimit dhe logjistika e transporti. Nga aspekti i shtrirjes gjeografike, bizneset e intervistuar operojnë në Prishtinë, Pejë, Gjilan, Podujevë, Prizren dhe Ferizaj. Të dhënat që kanë të bëjnë me shifrat e anëtarësisë në shoqata janë marrë kryesisht nga informacioni publik i disponueshëm në uebsajtet e odave ekonomike dhe shoqatave të biznesit, si dhe përmes kërkesave formale drejtuar rrjeteve të biznesit. Meqenëse të dhënat e ofruara nga këto rrjete nuk ishin të ndara sipas gjinisë, Instituti GAP bëri kryqëzimin e të dhënave të pronësisë sipas gjinisë duke përdorur platformën interaktive të Agjencisë së Regjistrimit të Bizneseve në Kosovë (ARBK).¹

Ndër odat ekonomike që morën pjesë në intervista ose ofruan të dhëna përfshihen: Oda Ekonomike e Kosovës (OEK), Oda Ekonomike Kosovë-Izrael (OEKI), G7 Kosova, Oda Ekonomike Gjermano-Kosovare (OEGJK), dhe pjesërisht Unioni i Turizmit në Kosovë. Shoqatat e biznesit pjesëmarrëse ishin: Organika, PePeKo dhe Mjedra e Kosovës.

Të dhënat u analizuan në bazë të prioriteteve, nevojave dhe interesave të identifikuar në hulumtimet e mëparshme nga Instituti GAP për çështje të ngjashme që prekin NMVM-të në pronësi të grave dhe ato në pronësi të pakicave etnike.² Gjetjet e studimit janë të kufizuara për shkak të mungesës së të

1 Agjencia e Regjistrimit të Bizneseve në Kosovë (ARBK) operon në kuadër të Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë dhe mbikëqyr regjistrimin e të gjitha bizneseve që operojnë në Kosovë. ARBK përfshin informacione mbi pronësinë, kapitalin e biznesit dhe të ngjashme. Prandaj, në mungesë të të dhënave të zberthyer sipas gjinisë, u përdor kjo platformë për të përcaktuar pronarët e bizneseve të targetuara.

2 Instituti GAP. [Profillet e bizneseve](#): Ndërmarrësia e grave dhe pakicave etnike në Kosovë, 2023; Instituti GAP, [Në kërkim të barazisë financiare](#): Qasja në financa për bizneset në pronësi të grave dhe të pakicave etnike, 2023; Instituti GAP, [Sfidat dhe mundësitë e qasjes në treg për bizneset në pronësi të grave dhe të komuniteteve pakicë në Kosovë](#), 2024.

dhënave të disponueshme për bizneset në pronësi të pakicave etnike. Shumica e rrjeteve të biznesit qoftë nuk kanë anëtarë që i përkasin pakicave etnikeose nuk i zbërthejnë të dhënat e tyre sipas përkatësisë etnike. Mirëpo, shoqatat si Organika, PePeKo dhe Mjedra e Kosovës ofruan datasete që zbërthejnë të dhënat e pronësisë së biznesit sipas gjinisë dhe përkatësisë etnike. Këto shoqata raportojnë anëtarësi nga pronarë të bizneseve të përkatësisë etnike serbe dhe boshnjake.

Bazuar në gjetjet e konstatuara, raporti ofron rekomandime për palët e interesuara, duke përfshirë Qeverinë e Kosovës; odat ekonomike, rrjetet dhe shoqatat e biznesit; dhe donatorët vendorë dhe ndërkombëtarë. Këto rekomandime kanë për qëllim të kontribuojnë në objektivin e Aktivitetit të USAID-it Angazhimi Gjithëpërfshirës Ekonomik(IEEA) për partneritete të qëndrueshme biznesi mes bizneseve në pronësi të grave dhe të pakicave etnike, odave ekonomike, shoqatave dhe rrjeteve të tjera.

1. Roli i rrjetëzimit për bizneset në pronësi të grave dhe të ato në pronësi të pakicave etnike

Në Kosovë, bizneset në pronësi të grave zakonisht punojnë në një shkallë më të vogël brenda sektorëve me norma më të ulëta kthimi në investim dhe shpesh veprojnë brenda ekonomisë joformale. Studimet tregojnë disa pengesa që kontribuojnë në praktikën e tyre joformale, duke përfshirë sfidat që lidhen me regjistrimin e biznesit,³ konkurrencën e padrejtë,⁴ mangësitë e digjitalizimit dhe tronditjet ekonomike si ato të shkaktuara nga pandemia e COVID-19.⁵ Rrjedhimisht, këto biznese shpesh shfaqin produktivitet më të ulët të punës,⁶ ndërkohë që kufizimet e tjera financiare pengojnë më tej qëndrueshmërinë dhe rritjen e tyre. Për më tepër, për shkak se janë biznese më të vogla dhe kanë kontakte të kufizuara, bizneset në pronësi të grave dhe "ato" në pronësi të pakicave etnike shpesh përballen me sfida në qasje ndaj burimeve si kapitali dhe mundësitë për ngritjen e aftësive.⁷ Aktualisht, mbështetja për këto biznese rrjedh kryesisht nga organizatat joqeveritare (OJQ), si vendore ashtu edhe ndërkombëtare.⁸

Përveç kësaj, bizneset në pronësi të grave dhe ato në pronësi të pakicave etnike janë të nën-përfaqësuar në rrjetet tradicionale të biznesit. Për bizneset mikro dhe të vogla në pronësi të grave, gjetjet tregojnë se tarifat e larta të anëtarësisë në rrjetet e biznesit janë shpesh pengesë për to, duke e bërë të vështirë krijimin e partneriteteve me biznese të tjera të shitjes me pakicë ose zgjerimin e veprimtarisë së tyre përtej Kosovës.⁹ Si rezultat, këto biznese zakonisht mbështeten në bashkëpunimin dhe rrjetëzimin me biznese të ngjashme dhe në komunitete më të vogla.

Megjithatë, studimet theksojnë rëndësinë e rrjetëzimit për fuqizimin e bizneseve duke ofruar qasje në burime, mundësi, njohuri, mbështetje dhe ndjesinë e komunitetit, duke kontribuar potencialisht në suksesin dhe qëndrueshmërinë e tyre.¹⁰ Në Kosovë, rrjetëzimi kontribuon në krijimin e mundësive për partneritete

3 UNDP, [Women Entrepreneurs as Drivers of Business Integrity](#). 2023.

4 Instituti Riinvest, [Ndërmarrësia e grave; Analizë e të bërit biznes në Kosovë](#). 2017.

5 Gardner J., et al. [Engendering informality statistics: gaps and opportunities](#). Organizata Ndërkombëtare e Punës.

6 World Bank Blogs, [Understanding gender gaps in the informal sector](#). 2023

7 Barr, M.S. [Minority and Women Entrepreneurs: Building Capital, Networks, and Skills](#). The Brookings Institution, 2015.

8 Po aty

9 Instituti GAP. [Sfidat dhe mundësitë e qasjes në treg për bizneset në pronësi të grave dhe të komuniteteve pakicë në Kosovë](#), 2024.

10 Hifzhan, F.T. Mochammad, H.E. [The Networks in Encouraging Women to Start and Sustain Businesses: Systematic Literature Review](#). International Journal of Health, Economics, and Social Sciences (IJHES). 2023.

biznesi, bashkëpunim dhe zhvillim të përgjithshëm të biznesit.¹¹ Ndërtimi i marrëdhënieve me biznese, furnizues dhe klientë të tjerë avancojnë dukshmërinë dhe rrit mundësitë për të siguruar kontrata ose për të hyrë në tregje të reja.¹²

Gjetjet nga hulumtimet e Institutit GAP sugjerojnë se anëtarësia në rrjetet e biznesit luan gjithashtu rol jetik që bizneset në pronësi të grave dhe "ato" në pronësi të pakicave etnike të mbahen të informuara për mbështetjen e disponueshme, trendet në treg, strategjitë e biznesit dhe zhvillimet e industrisë, si dhe në ofrimin e një forumi në të cilin mund të shkëmbehen ide me bashkëveprimtarët dhe ekspertët e industrisë.¹³ Këto rrjete shërbejnë gjithashtu si forume të rëndësishme për lidhjen e bizneseve me mundësi potenciale për mbështetje. Duke e njohur këtë rol, iniciativat si Aktiviteti i USAID-it Angazhimi Gjithëpërfshirës Ekonomik (IEEA) mbështesin bizneset mikro dhe të vogla në pronësi të grave dhe në pronësi të pakicave etnike për t'iu bashkuar shoqatave të ndryshme të biznesit në Kosovë.¹⁴ Për më tepër, gjetjet e këtij raporti tregojnë se bizneset në pronësi të grave shpesh krijojnë marrëdhënie kryesisht me biznese të tjera në pronësi të grave, të ndihmuara nga rrjetet e krijuara posaçërisht për gratë ndërmarrëse.¹⁵ Ky rrjetëzim kultivon ndjesinë e komunitetit dhe përkatësisë, duke lehtësuar ndjesinë e izolimit dhe duke ofruar forum për shkëmbimin e këshillave, inkurajimit dhe solidaritetit ndërmjet bashkëveprimtarëve që përballen me sfida të ngjashme.¹⁶

2. Praktikë ndërkombëtare dhe rajonale të rrjetëzimit për NMVM-të

Pavarësisht rritjes së pjesëmarrjes së grave në tregun e punës, ende ka një përqindje më të madhe të bizneseve në pronësi të burrave.¹⁷ Studimet tregojnë se bizneset në pronësi të grave dhe "ato" në pronësi të pakicave etnike shpesh hasin sfida në realizimin e qasjes në rrjete efektive të biznesit, pavarësisht se potencialisht mund të përfitojnë më shumë nga rrjete të tilla.¹⁸ Rrjetëzimi brenda odave ekonomike dhe shoqatave të biznesit ofron mundësi të rëndësishme për bizneset për të shkëmbyer përvoja, për të fituar njohuri nga bashkëveprimtarët dhe për të mbështetur njëri-tjetrin.¹⁹ Prandaj, anëtarësia në rrjetet e biznesit mund të ofrojë mundësi për ndërmarrësit, dhe në rastin e Kosovës, mund t'u ofrojë grave ndërmarrëse mundësinë për të realizuar qasjen shumë të nevojshme në burime që përndryshe nuk do t'i kishin në dispozicion. Kur ndërmarrësit ndajnë qëllime të përbashkëta dhe bashkëpunojnë për të prezantuar risi, ata krijojnë rrjete që, nga ana tjetër, krijojnë avantazhe konkurruese nga të cilat përfitojnë këto biznese.²⁰

Në nivel global, ekzistojnë strategji të ndryshme që përdoren nga rrjetet e

11 Krasniqi, E. Kume, A. [Entrepreneurship and Strategic Management in Emerging Economies: Kosovo's Perspective](#). 2013.

12 Gjetje të përgjithshme nga Instituti GAP. [Sfidat dhe mundësitë e qasjes në treg për bizneset në pronësi të grave dhe të komuniteteve pakicë në Kosovë](#), 2024.

13 Instituti GAP. [Sfidat dhe mundësitë e qasjes në treg për bizneset në pronësi të grave dhe të komuniteteve pakicë në Kosovë](#), 2024.

14 Bazuar në njohuritë që dolën nga intervistat, IEEA bashkëpunon me disa shoqata sektoriale të biznesit për të mbështetur bizneset në pronësi të grave dhe në pronësi të pakicave etnike në Kosovë që të anëtarësohen në këto shoqata.

15 Instituti GAP. [Sfidat dhe mundësitë e qasjes në treg për bizneset në pronësi të grave dhe të komuniteteve pakicë në Kosovë](#), 2024.

16 Po aty.

17 Organizata Ndërkombëtare e Punës. [How to Reach out to Women Entrepreneurs](#).

18 Barr, M.S. [Minority and Women Entrepreneurs: Building Capital, Networks, and Skills](#). The Brookings Institution, 2015. f.6

19 Ratoi, E. [Strengthening Women's Economic Empowerment through Networking: A Focus on Women Entrepreneurs in Europe and Central Asia](#). 2023.

20 Miller, N. J., Besser, T. L., & Vigna, D. [Networking Among Apparel Store Owners in Small U.S. Communities: Developing Social Capital](#). 2011. f. 83-97.

bizneseve për të nxitur mundësi rrjetëzimi që ofrojnë mbështetje vendimtare për bizneset në pronësi të grave dhe "ato" në pronësi të pakicave etnike. Për shembull, Shoqata Kombëtare e Grave Pronare Biznesi (NAWBO) në Shtetet e Bashkuara lehtëson rrjetëzimin përmes ngjarjeve, punëtorive dhe seminareve të përshtatura enkas për nevojat e grave ndërmarrëse.²¹ Shoqëria e Grave në Biznes në Kanada (WBE) ofron mundësi rrjetëzimi, programe mentorimi dhe punëtori edukative për gratë ndërmarrëse.²² Nga ana tjetër, Këshillat e Zhvillimit të Furnizuesve nga Komunitetet Pakicë (të njohura si MSDCs) në Shtetet e Bashkuara fokusohen në çertifikimin dhe mbështetjen e bizneseve në pronësi të pakicave etnike nëpërmjet ngjarjeve të rrjetëzimit dhe programeve të zhvillimit të biznesit.²³

Po kështu, rrjetet e biznesit luajnë rol vendimtar në ofrimin e mundësive për komunitetin e biznesit edhe në vendet e Ballkanit Perëndimor. Tarifat dhe aktivitetet e anëtarësisë së rrjeteve të biznesit ndryshojnë sipas vendit, madhësisë së kompanisë dhe ofertave të tjera promovionale. Në disa prej këtyre vendeve, aktivitetet e rrjeteve të biznesit rregullohen me kornizë ligjore. Për shembull, Oda Ekonomike e Malit të Zi, rrjeti kryesor i biznesit në vend, funksionon në përputhje me Ligjin për Odën Ekonomike të Malit të Zi i cili përcakton tarifën e anëtarësisë për të gjitha bizneset në Mal të Zi. Sipas kësaj rregulloreje, në vend të tarifës fikse, anëtarët paguajnë normën prej 0.27% të pagës bruto të punonjësit në bazë të tatimeve dhe kontributeve të paguara nga bizneset.²⁴ Ndërkohë që për ndërmarrësit kjo tarifë llogaritet në bazë të të ardhurave nga vetëpunësimi të raportuara në deklaratën vjetore tatimore.²⁵

Në Shqipëri, dhomat e tregtisë krijohen me Ligjin për Dhomat e Tregtisë dhe Industrisë.²⁶ Ky ligj, ndër të tjera, rregullon kompetencat e dhomës, formimin e Asamblesë dhe afatet e anëtarësisë (përveç tarifës vjetore të anëtarësisë).²⁷ Këto rrjete janë përgjegjëse për bashkimin e sipërmarrjeve dhe sipërmarrësve, ofrimin e mundësive të rrjetëzimit dhe bashkëpunimin mes tyre, me synimin për të nxitur rritjen ekonomike në Shqipëri. Legjislacioni shqiptar rregullon gjithashtu Bashkimin e Dhomave të Tregtisë dhe Industrisë, i cili operon në nivel kombëtar duke bashkërenduar të gjitha rrjetet dhe me rol kryesor avokimin për politikë-bërje.²⁸

Në mënyrë të ngjashme, në Serbi, rrjetet e biznesit janë të rregulluara me kornizë ligjore dhe të gjitha shoqatat sektoriale janë pjesë e Odës së Tregtisë dhe Industrisë. Kjo odë ekonomike, e përcaktuar me ligj si shoqatë e kompanive dhe ndërmarrësve, është shoqatë kombëtare e të gjithë biznesmenëve serbë, e cila u shërben interesave të anëtarëve të saj dhe ekonomisë serbe.²⁹ Tarifa e anëtarësisë nuk është i rregulluar me ligj; në vend të kësaj, tarifa përcaktohet sipas diskrecionit të rrjeteve dhe nuk është informacion në dispozicion publik.

21 National Association of Women Business Owners (NAWBO).

22 [Women's Business Enterprise Canada \(WBE\)](#).

23 [National Minority Supplier Development Council \(NMSDC\)](#).

24 Gazeta Zyrtare e Malit të Zi, 112/23, datë 15 dhjetor 2023. Informacion i marrë përmes kërkesave për të dhëna nga Oda Ekonomike e Malit të Zi.

25 Po aty

26 Kuvendi i Republikës së Shqipërisë. [Ligji nr. 9897, "Për dhomat e tregtisë dhe industrisë", datë 10.04.2008](#).

27 Po aty

28 Po aty

29 [Oda e Tregtisë dhe Industrisë e Serbisë](#)

3. Praktikrat e rrjetëzimit në Kosovë³⁰

3.1. Analizë e odave ekonomike dhe shoqatave të biznesit në Kosovë

Rrjetet e biznesit janë të përkushtuara për të avancuar interesat e anëtarëve të tyre.³¹ Shumica e rrjeteve të biznesit në Kosovë janë të rregulluara me Ligjin e Kosovës për Lirinë e Asociimit në OJQ.³² Këto rrjete krijohen nga anëtarësia vullnetare e individëve me interes të përbashkët. Si të tilla, rrjetet e biznesit mund të përfshijnë odat ekonomike dhe shoqatat e tjera të biznesit. Ndër odat ekonomike dhe shoqatat e biznesit kryesore që lidhin ndërmarrësit në Kosovë përfshihen: OEK, Oda Ekonomike Amerikane (AmCham), OEGJK, OEKI, Oda Ekonomike Kosovë-Turqi (OEKT), G7 Kosova, PePeKo, Organika, Shoqata për Teknologji të Informacionit dhe Komunikimit të Kosovës (STIKK), Shoqata e Bizneseve dhe Artizanatit (EsnaF) dhe shoqata të ngjashme që përbëhen nga përfaqësues të bizneseve në pronësi të grave dhe ato në pronësi të pakicave etnike.

OEK është i vetmi rrjet i biznesit i krijuar me ligj dhe i miratuar nga Kuvendi i Kosovës.³³ Duke shtrirë veprimtarinë e vet mbi 60 vjet, deri në ditët e sotme, OEK ka rreth 16 mijë anëtarë dhe është e organizuar me zyra shoqate në shtatë njësi rajonale (Prishtinë, Mitrovicë, Pejë, Prizren, Gjilan, Ferizaj dhe Gjakovë), si dhe ka pesë departamente. Anëtarësia është vullnetare.³⁴

Të gjitha odat ekonomike dhe shoqatat e biznesit të tjera vendosin statutet e tyre dhe tarifrat e tyre të anëtarësisë siç e shohin të arsyeshme në përputhje me Ligjin për Lirinë e Asociimit.³⁵ Odat ekonomike zakonisht operojnë në interes të krijimit të mundësive të biznesit ndërmjet Kosovës dhe një shteti tjetër, shembull Oda Amerikane përpiqet të forcojë marrëdhëniet ekonomike ndërmjet Kosovës dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Në anën tjetër, shoqatat sektoriale janë të fokusuar në aktivitetin primar të biznesit, siç është Organika e cila promovon vetëm produkte organike, ose Mjedra e Kosovës, anëtarët e së cilës kultivojnë mjedra apo pemla të tjera.

Financimi i odave ekonomike vjen kryesisht nga tarifrat e anëtarësisë, me disa projekte anësore të financuara nga donatorë ndërkombëtarë si USAID, Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZh) dhe Fondi Monetar Ndërkombëtar (FMN). Në mënyrë të ngjashme, shoqatat sektoriale financohen nga donatorë ndërkombëtarë dhe vendorë dhe projekte të ndryshme, disa prej të cilave synojnë të përfshijnë dhe të ndihmojnë gratë ndërmarrëse të realizojnë qasje në mundësi rrjetëzimi; mirëpo, tarifrat e tyre të anëtarësisë përbëjnë pjesë më të vogël të financimit të tyre.³⁶ Megjithatë, financimi i këtyre odave është zakonisht i vogël dhe mezi mund të mbulojë shpenzimet e tryezave të rrumbullakëta dhe punëtorive ku ndërmarrësit përfshihen në rrjetëzim.³⁷

30 Në Kosovë, përveç Odës Ekonomike të Kosovës (OEK), e cila është themeluar me [Ligjin nr. 2004/7 për Odën Ekonomike të Kosovës](#), të gjitha shoqatat e tjera të biznesit janë të regjistruara si OJQ, sipas [Ligjit nr. 06/L-043 për Lirinë e Asociimit në Organizata Joqeveritare](#). Odë Ekonomike është shoqata e biznesit e bazuar në anëtarësi me statusin e vet unik, e përbërë nga lloje të ndryshme biznesesh dhe e përkushtuar për përfaqësimin e interesave të anëtarëve të vet, si Oda Ekonomike Amerikane (AmCham), Oda Ekonomike Gjermano-Kosovare (KDWV), Oda Ekonomike Kosovë-Turqi (KTCC) dhe Dhoma Ekonomike e Grave të Kosovës (G7). Shoqatë e Biznesit Sektorial është shoqata e bazuar në anëtarësi që ka statutin e saj, e fokusuar në sektorë specifikë të industrisë si Shoqata e Përpunuesve të Pemëve dhe Perimeve në Kosovë (PePeKo), Shoqata e Bizneseve për Produkte Pyjore Jo-drusore dhe Bimë Mjekësore dhe Aromatike (Organika), Shoqata e Bizneseve dhe Artizanatit (EsnaF), Mjedra e Kosovës dhe Unioni i Turizmit në Kosovë.

31 USAID Edge Project. [The Business Association Development Guidebook: A practical guide to building organizational capacity.](#)

32 Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës. [Ligji nr. 06/L-043 për Lirinë e Asociimit në Kosovë.](#)

33 Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës. [Ligji nr. 2004/7 për Odën Ekonomike të Kosovës.](#)

34 Po aty.

35 Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës. [Ligji nr. 06/L-043 për Lirinë e Asociimit në Kosovë.](#)

36 Gjetjet nga intervistat me shoqatat e biznesit.

37 Gjetjet nga intervistat me shoqatat e biznesit.

Rrjetet e biznesit, veçanërisht odat ekonomike, shpesh iniciojnë masa që synojnë të fuqizojnë ndërmarrësinë e grave. Për shembull, OEGJK ka nënshkruar një memorandum me UN Women në Kosovë për promovimin e barazisë gjinore dhe fuqizimin e grave në vendin e punës, treg dhe komunitet përmes promovimit dhe implementimit efektiv të Parimeve të Fuqizimit të Grave (WEP);³⁸ ky memorandum ka ofruar trajnim në nivel ndërkombëtar dhe ka financuar pjesëmarrjen në konferenca për disa gra ndërmarrëse në Kosovë.³⁹ Oda Amerikane në Kosovë ka themeluar një komitet për "Gratë Lidere" duke ofruar një vend ku gratë mund të diskutojnë sfidat, të shkëmbejnë ide dhe përvoja dhe të shërbejnë si model, duke promovuar ndërmarrësinë e grave, duke rritur potencialisht barazinë gjinore dhe duke fuqizuar gratë pronare të biznesit në Kosovë.⁴⁰ Në mënyrë të ngjashme, OEK ka themeluar një zyrë të dedikuar për të mbështetur bizneset dhe startup-et në pronësi të grave, me qëllim të promovimit të përfshirjes aktive të grave ndërmarrëse brenda Odës. Ndërsa G7 Kosova, e përbërë vetëm nga gra ndërmarrëse, vazhdimisht shtyn përpara vizionin e tyre për lehtësimin, lobimin, promovimin dhe përfaqësimin e grave në mjedisin ekonomik.⁴¹ Megjithatë, asnjë nga këta subjekte nuk ka programe specifike për të mbështetur dhe promovuar bizneset në pronësi të pakicave etnike.

3.2. Nevojat për rrjetëzimin e bizneseve në pronësi të grave: Analiza e gjetjeve nga intervistat me biznese mikro dhe të vogla në pronësi të grave dhe ato në pronësi të pakicave etnike

Gjetjet e intervistave me gratë pronare të biznesit dhe individë ngapakicat etnike tregojnë vullnet të madh për t'u angazhuar në odat ekonomike dhe shoqatat e biznesit; të intervistuarat/it dukej se e kuptonin që rrjetëzimi është vendimtar për veprimtarinë e bizneseve të tyre. Shumica e grave dhe ndërmarrësve nga pakicat etnike që u intervistuan (67%) janë pjesë e rrjeteve të biznesit, duke përfshirë odat ekonomike, OJQ-të ose shoqatat e tjera të biznesit. Prandaj, këto rrjete ofrojnë mundësi të çmuara për qasje në programe trajnimi, grante, burime të tjera dhe informacione që përndryshe do të ishin të paarrtshme për gratë dhe ndërmarrësit nga pakicat etnike.

Odat ekonomike ofrojnë avantazhe thelbësore për bizneset, duke ofruar mundësi të çmuara për rrjetëzim, si brenda ashtu edhe jashtë vendit; qasje në programe trajnimi; mundësi për t'u lidhur me klientët potencialë; dhe mbështetje për promovimin e produkteve apo shërbimeve të ofruara nga bizneset. Megjithatë, tarifat e larta të anëtarësisë paraqesin pengesa për mikro-bizneset që synojnë anëtarësinë. Duke qenë se odat ekonomike zbatojnë tarifa vjetore duke filluar nga 150 euro, pronarët e bizneseve pretendojnë se për shkak të luhatjeve të shitjeve dhe pasigurisë së përgjithshme të fitimit, nuk mund t'i përballojnë këto tarifa.

Megjithatë, disa shoqata biznesi ose oda ekonomike ofrojnë shërbime unike në krahasim me rrjetet e tjera, duke stimuluar në këtë mënyrë anëtarësinë. Për shembull, OEK ofron barkode të produkteve të nevojshme për bizneset në sektorin e prodhimit për të hyrë në tregun e Kosovës me vendosjen e produkteve. Rrjedhimisht, ka një tendencë të bizneseve në pronësi të grave që t'i bashkohen OEK-ut dhe të zgjedhin tarifën bazë të anëtarësisë. Megjithatë, përkundër pakove të ndryshme të anëtarësisë që ofrojnë përfitime, gjetjet tregojnë se përfitimet nga pakot bazë në OEK mund të mos përmirësojnë mjaftueshëm performancën e përgjithshme të biznesit. Në anën tjetër, bizneset në pronësi

38 Platformë ndërkombëtare e krijuar nga Global Compact dhe UN Women.

39 Ndër bizneset e intervistuar, një i tillë me pronare grua mori pjesë në një konferencë, që mbahet në Turqi, duke përfaqësuar Kosovën falë kësaj marrëveshjeje ndërmjet KDWW dhe UN-Women.

40 Oda Ekonomike Amerikane në Kosovë. [Gratë Lidere](#).

41 [Oda Ekonomike e Grave të Kosovës](#).

të grave që paguajnë tarifa më të larta për pakot që ofrojnë përfitime shtesë, pretendojnë se kanë përfituar shumë nga anëtarësia në OEK, veçanërisht falë rrjetëzimit dhe krijimit të marrëdhënieve brenda një baze të madhe anëtarësh.

Informacioni i marrë përmes kërkesave për të dhëna dhe njohuritë që dolën nga intervistat zbulojnë më tej se bizneset në pronësi të grave janë të nën-përfaqësuara në odat ekonomike të tjera (si Oda Amerikane, OEGJK) dhe shoqatat e tjera të biznesit (si CEED). Në mënyrë të ngjashme, bizneset në pronësi të pakicave etnike janë të nën-përfaqësuara ose trajtohen si subjekte biznesi pa asnjë konsideratë të posaçme si pakica. Të intervistuarit u shprehën se norma e ulët e anëtarësisë nga radhët e bizneseve në pronësi të grave dhe pakicave etnike është kryesisht për shkak të tarifave të larta të anëtarësisë. Të intervistuarit, duke përfshirë edhe bizneset në pronësi të grave edhe ato në pronësi të pakicave etnike, të cilët janë anëtarësuar në një nga shoqatat e sipërpërmendura, u shprehën se për shkak të tarifave të larta të anëtarësisë ata zakonisht mund të përballojnë anëtarësinë vetëm në një shoqatë ose odë ekonomike; ata shpjeguan se kur përcaktojnë se në cilën shoqatë do të anëtarësohen, zakonisht peshojnë përfitimet nga secila shoqatë.

Përveç odave ekonomike dhe shoqatave të biznesit të krijuara vetëm për qëllime të rrjetëzimit të biznesit, bizneset mikro dhe të vogla në pronësi të grave shpesh u bashkohen radhëve të shoqatave të grave. Ndonëse nuk ka nevojë të paguhen tarifa për t'u anëtarësuar në to, shoqatat si "Besila" në Prizren, "Shoqata e Grave Fati" në Bërnice dhe "Gruaja Hyjnore" në Gjilan ndër shumë të tjera, ofrojnë përfitime të ngjashme me ato të odave ekonomike për bizneset në pronësi të grave. Disa nga përfitimet përfshijnë informacione rreth granteve, subvencioneve dhe projekteve; rrjetëzim me biznese të tjera; trajnim; dhe mundësi për të marrë pjesë në panairë të ndryshme ku bizneset mund të ekspozojnë produktet e tyre.

Të gjitha bizneset e intervistuar të anëtarësuar në një rrjet biznesi deklaruan se kanë marrë informacion nga të paktën një odë ekonomike apo shoqatë biznesi. Ekziston një grup i vogël i të intervistuarve që nuk janë anëtarë të asnjë shoqate biznesi; këta pronarë biznesesh pretendojnë se nuk kanë marrë kurrë informacion në lidhje me përfitimet e anëtarësisë në rrjet. Për këtë arsye ata nuk kanë kërkuar asnjëherë anëtarësinë në shoqata biznesi. Në mesin e bizneseve që zgjedhin të mos anëtarësohen në ndonjë nga rrjetet e sipërpërmendura të biznesit, ka disa biznese në pronësi të grave që pretendojnë se rrjetet e biznesit (si odat ekonomike) janë të gjitha të vendosura në Prishtinë, duke paraqitur vështirësi që përfaqësuesit e këtyre bizneseve të udhëtojnë dhe të marrin pjesë në takime/ngjarje nga qytetet tjera të Kosovës.

Nga ana tjetër, të intervistuarit nga bizneset mikro dhe të vogla në pronësi të grave dhe në pronësi të pakicave etnike, që synojnë të promovojnë produktet ose shërbimet e tyre në panairë ndërkombëtare dhe të lidhen me partnerë ndërkombëtarë, u shprehën se nuk kanë qenë në gjendje të marrin pjesë në aktivitetet e mbështetura nga KIESA për shkak të kriterëve të rrepta të agjencisë. Shembujt e dhënë nga të intervistuarit tregojnë se kriteret e KIESA-s përfshijnë kërkesën për normë të lartë qarkullimi vjetor, që është vështirë të përmbushet nga bizneset në pronësi të grave për shkak të kapaciteteve të tyre të kufizuara.

3.3. Mundësitë e rrjetëzimit për bizneset në pronësi të grave dhe ato në pronësi të pakicave etnike: Analiza e gjetjeve nga intervistat me odat ekonomike dhe shoqatat e biznesit

Për të kuptuar këndvështrimin e odave ekonomike dhe të shoqatave të biznesit për përfshirjen e grave ndërmarrëse, u zhvilluan disa intervista. Përfaqësuesit e OEK-ut theksuan zotimin e tyre për avancimin e ndërmarrësisë së grave brenda Odës. Për të rritur pjesëmarrjen e bizneseve në pronësi të grave, OEK ka themeluar nën-shoqata të grave me tarifa anëtarësie që fillojnë nga 30 euro për anëtare. Për t'u formuar një nën-shoqatë e tillë, është e nevojshme të anëtarësohen të paktën tetë biznese në pronësi të grave. Kjo iniciativë u mundëson bizneseve më të vogla të kenë qasje në përfitimet e ofruara nga OEK, duke përfshirë pjesëmarrjen në sesione trajnimi, punëtori dhe mundësi rrjetëzimi të përshtatura enkas për nevojat e tyre. Meqenëse kjo iniciativë është krijuar rishtazi, efektet e saj ende nuk janë parë.

Në anën tjetër, G7 Kosova fokusohet ekskluzivisht në bizneset në pronësi të grave, bizneset e përfaqësuar nga gratë dhe bizneset ku shumica e të punësuarve janë gra. Një shqetësim i theksuar që u shpreh gjatë intervistës ishte se bizneset mikro dhe të vogla shpesh ngatërrojnë rolet e odave ekonomike dhe shoqatave të biznesit. Bizneset janë të prira t'u japin përparësi përfitimeve afatshkurtra si grantet dhe burimet e prekshme kundrejt avantazheve afatgjata të përfaqësimit në iniciativa avokimi. Më tej, këto iniciativa përfshijnë konsultime dhe rekomandime për projektligje të rëndësishme për gratë ndërmarrëse.

Shoqatat sektoriale si PePeKo, Organika dhe Mjedra e Kosovës punojnë me biznese në sektorin e agrobiznesit. Këto shoqata u ofrojnë anëtarëve të tyre qasje në informacione rreth panairëve, ngjarjeve, granteve, subvencioneve, mbështetjes teknike, avokimit, lobimit dhe qasjes në treg dhe Organika është subjekti i vetëm në Kosovë që ndihmon bizneset të marrin certifikimin e produkteve organike. Pavarësisht se kanë tarifë vjetore të anëtarësisë që mezi mbulon shpenzimet bazë të këtyre shoqatave, ato u ofrojnë anëtarëve mundësi rrjetëzimi dhe nxisin bashkëpunimin. Këto shoqata kanë prioritet avancimin e të gjitha bizneseve brenda sektorëve të tyre përkatës, pavarësisht nga gjinia e pronarit. Ato nuk kanë programe specifike për të adresuar dhe avancuar nevojat e grave apo ndërmarrësve nga pakicat etnike. Sipas PePeKo, bizneset mikro në pronësi të grave, veçanërisht ato në zonat rurale të Kosovës, shpesh çalojnë në kanalizimin e problemeve të tyre dhe komunikimin e nevojave të tyre të biznesit, gjë që vë në pah nevojën për asistencë të përshtatur enkas. Në lidhje me nevojat e bizneseve në pronësi të pakicat etnike, gjetjet nga intervistat me këto tri shoqata zbulojnë se bizneset në pronësi të pakicave etnike shpesh tregojnë pak interes për të marrë pjesë në aktivitete të avokimit dhe lobimit, edhe kur ftohen.

Pjesëmarrja në panairë vendore dhe ndërkombëtare ofron mundësi të shumta biznesi, si promovimi i produkteve, gjetja e blerësve dhe distributorëve potencialë dhe rrjetëzimi me biznese të tjera. Unioni i Turizmit në Kosovë organizon Panairin Ndërkombëtar të Turizmit me qëllim të forcimit të rrjetëzimit ndërmjet pjesëmarrësve. Ky panair tërheq qindra biznese vendore dhe ndërkombëtare të përfaqësuar nga burra dhe gra. Megjithatë, Unioni i Turizmit pretendon se pavarësisht përpjekjeve për subvencionimin dhe mbështetjen e bizneseve të përfaqësuar nga gratë dhe pakicat etnike, tarifatat e pjesëmarrjes për panairë të ndryshme mbeten pengesë për shumë mikro biznese.

4. Analiza e anëtarësisë sipas gjinisë

Nën-përfaqësimi i grave ndërmarrëse në mjedisin ekonomik të Kosovës është evident, me vetëm 18% të totalit të bizneseve në pronësi të grave dhe 2.3% në bashkëpronësi të së paku një gruaje. Ky disparitet reflektohet në mënyrë të ngjashme në përfaqësimin e tyre të kufizuar në shoqatat e biznesit. Një analizë e anëtarësisë në odat ekonomike në Kosovë zbulon se bizneset në pronësi të grave përbëjnë një përqindje shumë të vogël të anëtarësisë së përgjithshme. Konkretisht, bizneset në pronësi të grave përbëjnë:

- 0.5% të totalit të anëtarëve në Odën Ekonomike të Kosovës,
- 1.9% të totalit të anëtarëve në Odën Ekonomike Amerikane në Kosovë,
- 4.2% të totalit të anëtarëve në Odën Ekonomike Gjermano-Kosovare,
- 3.8% të totalit të anëtarëve në Odën Ekonomike Kosovë-Turqi, dhe
- 5.5% të totalit të anëtarëve në Odën Ekonomike Kosovë-Izrael.

G7 Kosova, përkundrazi, dallohet pasi fokusohet vetëm në përfaqësimin e bizneseve në pronësi të grave, bizneseve të menaxhuara nga gratë dhe bizneseve ku shumica e të punësuarve janë gra. Kjo e bën që G7 Kosova të shquhet si veçanti në krahasim me shoqatat e tjera për shkak të kritereve të paracaktuara të anëtarësisë.

Raporti i Institutit GAP për profilet e biznesit në Kosovë tregon se bizneset në pronësi të grave janë të angazhuara kryesisht në tregti me shumicë dhe pakicë (27.0%), aktivitete shërbimi (17.1%) dhe prodhim (17.0%).⁴² Kjo shpërndarje sektoriale është reflektuar edhe në anëtarësinë e bizneseve në shoqatat e analizuar në këtë raport. Bizneset në pronësi të grave që janë anëtare të odave ekonomike të renditura në tabelat 1 dhe 2 janë të angazhuara kryesisht në sektorin e tregtisë me shumicë dhe pakicë, ndjekur nga prodhimi, bujqësia, pylltaria e peshkimi, dhe aktivitete të tjera shërbimi.

Është e rëndësishme të theksohet se në tabelën 1 mungojnë të dhënat për bizneset në pronësi të pakicave etnike, pasi odat ekonomike ose nuk kishin anëtarë të asnjë grupi minoritar ose nuk e ofruan këtë informacion.

Tabela 1. Anëtarësia e bizneseve në pronësi të grave në odat ekonomike në Kosovë⁴³

Oda Ekonomike	Numri total i anëtarëve	Biznese në pronësi të grave ⁴⁴
OEK	16,000	80 (0.5%)
Oda Amerikane në Kosovë	211	4 (1.9%)
KDWV	166	7 (4.2%)
G7 Kosova ⁴⁵	94	84 (89.4%)
KTCC	52	2 (3.8%)
KICC	18	1 (5.5%)
KSCC ⁴⁶	60	N/D

Vini re: "N/D" tregon se të dhënat nuk janë të disponueshme.

⁴² Instituti GAP, Profilet e bizneseve: [Ndërmarrësia e grave dhe pakicave etnike në Kosovë](#), 2023.

⁴³ Veçanërisht, disa nga këto llogaritje mund të jenë të ndryshme nga shifra reale sepse shoqatat e renditura të biznesit mund të mos i kenë azhurnuar listat e anëtarësisë në uebsajtet e tyre. Mungon anëtarësia sipas pakicave etnike (nuk ka të dhëna). Disa të dhëna për pronësinë e bizneseve nuk gjenden në ARBK, gjë që paraqet kufizim për zbërthimin e anëtarësisë sipas gjinisë.

⁴⁴ Nuk përfshihen bizneset në bashkë-pronësi të grave dhe burrave.

⁴⁵ G7 Kosova tregon përqindje të lartë të bizneseve në pronësi të grave, duke reflektuar fokusin e saj në mbështetjen e grave ndërmarrëse.

⁴⁶ Oda Ekonomike Kosovë-Zvicër

Tabela 2. Anëtarësia e bizneseve në pronësi të grave dhe atyre në pronësi të pakicave etnike në shoqatat e biznesit në Kosovë⁴⁷

Shoqatat e biznesit	Numri total i anëtarëve	Biznese në pronësi të grave ⁴⁸	Biznese në pronësi të pakicave etnike
STIKK	59	9 (15.25%)	N/D
PePeKo	34	16 (47%)	5 (14.7%)
Organika	53	17 (32%)	6 (11.3%)
Mjedra e Kosovës	25	1 (4%)	3 (12%)
Esnaf	70	3 (4.3%)	N/D
Klubi i Prodhuesve të Kosovës	43	1 (2.3%)	N/D
Unioni i Turizmit në Kosovë	224	N/D	N/D

Vini re: "N/D" tregon se të dhënat nuk janë të disponueshme.

5. Tarifat e anëtarësisë dhe mundësitë që ofrohen

Përballueshmëria e anëtarësisë në odat ekonomike varet nga tarifrat përkatëse, të cilat mund të ndikojnë shumë te MSME-të, duke i bërë odat ekonomike me tarifa të arsyeshme më të qasshme dhe më të dobishme. Hulumtimet nga Instituti GAP sugjerojnë që bizneset në pronësi të grave dhe ato në pronësi të pakicave etnike janë të prirë të përmbahen nga aplikimi për anëtarësi për shkak të tarifave të larta që lidhen me rrjetet si odat ekonomike dhe shoqatat e tjera të biznesit.⁴⁹

Një analizë e tarifave të anëtarësisë për pakot e ofruara nga odat ekonomike dhe shoqatat e biznesit në tabelën 3 (shih shtojcën) tregon se bizneset paguajnë mesatarisht 1,233 euro në vit për odat ekonomike dhe 368 euro në vit për shoqatat e tjera të biznesit. Ndërsa shërbimet ndryshojnë ndërmjet rrjeteve, të gjitha ato ofrojnë përfitime bazë si rrjetëzimi i biznesit, pjesëmarrja në ngjarje të ndryshme, qasja në informacion, azhurnimet ligjore dhe qasja në treg.

Të gjitha rrjetet e renditura në tabelën 3 ofrojnë shërbime në bazë të tarifave të paguara të anëtarësisë, me kritere të përcaktuara nga secili institucion. Për shembull, OEK nuk ofron tarifë sipas pakos së shërbimeve; në vend të kësaj, shërbimet dhe tarifrat personalizohen bazuar në përzgjedhjet e anëtarëve.

Përveç tarifës bazë prej 150 eurosh, OEK ofron shërbime shtesë me kosto shtesë: 50 euro për referim për vizë biznesi; 200 euro për përdorimin e sallës së konferencës së Odës; 200 euro për lobim në institucionet përkatëse në bazë të kërkesave individuale të anëtarëve; 100 euro për gjenerimin e barkodeve; 250 euro për informacion mbi tenderët dhe grantet; 150 euro për informacion mbi projektligjet; dhe shërbime të tjera të zgjedhura nga anëtarët. Të gjithë anëtarët gëzojnë të drejtën për ulje prej 10% në panairt dhe trajnimet e organizuara nga OEK. Këshilla ligjore dhe verifikimi për dokumentacionin e eksportit është i disponueshëm me çmime të ndryshme (shih tabelën 3).

⁴⁷ Veçanërisht, disa nga këto llogaritje mund të jenë të ndryshme nga shifra reale sepse shoqatat e renditura të biznesit mund të mos i kenë azhurnuar listat e anëtarësisë në uebfaqet e tyre. Mungon anëtarësia sipas përkatësisë etnike (nuk ka të dhëna). Disa të dhëna për pronësinë e bizneseve nuk gjenden në ARBK, gjë që paraqet kufizim për zbrëthimin e anëtarësisë sipas gjinisë.

⁴⁸ Nuk përfshihen bizneset në bashkë-pronësi të grave dhe burrave.

⁴⁹ Instituti GAP. [Sfidat dhe mundësitë e qasjes në treg për bizneset në pronësi të grave dhe të komuniteteve pakicë në Kosovë](#), 2024.

6. Përfundim dhe rekomandime

Ky raport synon të analizojë pjesëmarrjen e bizneseve në pronësi të grave dhe atyre në pronësi të pakicave etnike në rrjete si odat ekonomike dhe shoqatat e ndryshme të biznesit në Kosovë, duke vlerësuar gjithashtu përbalueshmërinë e këtyre rrjeteve. Gjetjet nxjerrin në pah sfida të theksuara që rrjedhin nga kufizimet financiare dhe përfaqësimi i kufizuar në rrjetet tradicionale të biznesit. Pavarësisht këtyre sfidave, bizneset në pronësi të grave demonstrojnë reziliencë duke nxitur lidhje me komunitetin të cilat zbusin ndjesinë e izolimit.

Rrjetet kryesore të biznesit, siç është OEK, luajnë rol vendimtar në mbështetjen e këtyre ndërmarrësve. Korniza ligjore në Kosovë nënvizon rëndësinë e odave ekonomike dhe shoqatave të biznesit në promovimin e interesave kolektive të anëtarëve të tyre dhe lehtësimin e rritjes së sektorit privat. Në përgjithësi, ka nevojë për përpjekje të vazhdueshme për të minimizuar barrierat financiare, për të rritur përfaqësimin dhe për të fuqizuar ndërmarrësit nga radhët e grave dhe pakicave etnike brenda rrjeteve tradicionale.

Rekomandimet:

Për Qeverinë e Kosovës, donatorët ndërkombëtarë dhe vendorë, dhe palët e tjera të interesit:

- Të ndihmohen bizneset në pronësi të grave dhe ato në pronësi të pakicave etnike duke ofruar pako të personalizuar të anëtarësisë në shoqatat e biznesit.
- Të aplikohet trajtimi preferencial sipas kornizës ligjore të Kosovës⁵⁰ për të rritur përfaqësimin e bizneseve mikro dhe të vogla që kanë nevojë për mbështetje shtesë.
- Të vazhdohet me organizimin e panairëve dhe takimeve "Biznes-me-Biznes" (B2B) që synojnë ndërmarrjet në pronësi të grave dhe ato të pakicave etnike për të rritur ekspozimin e produkteve dhe mundësitë e rrjetëzimit, duke promovuar kështu fuqizimin ekonomik dhe barazinë gjinore.

Për odat ekonomike dhe shoqatat e biznesit:

- Të rivlerësohen tarifat e anëtarësisë si masë afirmative për të përfshirë më shumë biznese të vogla dhe mikro në pronësi të grave dhe ato në pronësi të pakicave etnike, duke nxitur mjedisin e biznesit më përfshirës, më novator dhe më të qëndrueshëm, që është i dobishëm si për bizneset ashtu edhe për shoqatat që mbështeten në tarifat e anëtarësisë.
- Të organizohen ngjarje të targetuara të rrjetëzimit për ndërmarrësit nga radhët e grave dhe pakicave etnike për të lehtësuar diskutimet dhe partneritetet strategjike.
- Të targetohen dhe të promovohen shërbimet e ofruara nga shoqatat e biznesit për të rritur ndërgjegjësimin e bizneseve në pronësi të grave dhe atyre në pronësi të pakicave etnike, duke siguruar që ata të kuptojnë përfitimet nga anëtarësia dhe rëndësinë e shoqatave të biznesit për rrjetëzimin.

50 [Ligji nr. 05/L-020 për Barazinë Gjinore, neni 6](#)

7. Shtojcë

Tabela 3. Tarifat vjetore të anëtarësisë⁵¹

Rrjeti	Pako 1	Pako 2	Pako 3	Pako 4	Pako 5
Oda Amerikane në Kosovë	250€	500€	750€	1,500€	3,500€
KDWW	300€	600€	900€	3,000€	-
KICC	1,200€	-	-	-	-
STIKK	80€	120€	250€	600€	2,500€
PePeKo	300€	-	-	-	-
Organika	100€	300€	500€	-	-
Mjedra e Kosovës	300€	-	-	-	-
Unioni i Turizmit në Kosovë	100€	150€	200€	-	-
Esnaf	30€	120€	240€	-	-
G7 Kosova	Pa përgjigje	Pa përgjigje	Pa përgjigje	Pa përgjigje	Pa përgjigje
KSCC	Pa përgjigje	Pa përgjigje	Pa përgjigje	Pa përgjigje	Pa përgjigje
CEED	Pa përgjigje	Pa përgjigje	Pa përgjigje	Pa përgjigje	Pa përgjigje
KTCC	Pa përgjigje	Pa përgjigje	Pa përgjigje	Pa përgjigje	Pa përgjigje

Tabela 3 ofron një pasqyrë të tarifave vjetore të anëtarësisë në euro për pako të ndryshme të ofruara nga rrjete biznesi dhe oda ekonomike të ndryshme në Kosovë. Disa rrjete nuk ofruan informacion specifik dhe kjo tregohet me "Pa përgjigje".

Pakot bazë të anëtarësisë zakonisht përfshijnë:

- Vërtetim regjistrimi,
- Pjesëmarrje në ngjarje, tryeza të rrumbullakëta dhe sesione trajnimi,
- Qasje në studime dhe raporte të kryera nga shoqata,
- Referime biznesi.

Pakot me kosto shtesë ofrojnë përfitime të zgjeruara si:

- Promovim biznesi dhe mundësi sponsorizimi,
- Verifikim të dokumenteve të eksportit,
- Përdorim të sallave të konferencave për ngjarje biznesi,
- Lobim tek institucionet në emër të kërkesave të bizneseve,
- Ulje për misionet tregtare rajonale dhe transatlantike,
- Rrjetëzim preferencial të biznesit në nivel të lartë,
- Përfitime nga pjesëmarrja në panairë ndërkombëtare,
- Reklamim të logove të bizneseve në uebsajtet apo ngjarjet e organizuara nga shoqatat, dhe
- Informacion mbi të gjitha ndryshimet legjislative dhe politikat publike që ndikojnë në zhvillimin ekonomik dhe interesa të tjera përkatëse që prekin shoqatat dhe anëtarët e rrjeteve.

⁵¹ Oda Ekonomike e Kosovës nuk është përfshirë në tabelë pasi zberthimi i tarifës është sipas shërbimeve dhe jo sipas pakos së shërbimeve. Tarifa minimale që paguajnë bizneset për t'u anëtarësuar në OEK është 150 euro në vit dhe në bazë të shërbimeve të kërkuara tarifa mund të shkojë deri në 2,155 euro në vit.

Instituti GAP është think-tank i themeluar në vitin 2007 në Kosovë. Qëllimi kryesor i GAP-it është të tërheqë profesionistë për të krijuar një ambient të zhvillimit dhe hulumtimit profesional, që haset në institucione të ngjashme në shtetet perëndimore. Kjo gjithashtu u ofron mundësi kosovarëve për hulumtimin, zhvillimin dhe implementim e projekteve me qëllim të avancimit të shoqërisë kosovare. Prioritet për këtë Institut është mobilizimi i profesionistëve në adresimin e sfidave ekonomike, politike dhe sociale të vendit. Qëllimet kryesore të GAP-it janë të plotësojë zbrazëtitë mes qeverisë dhe qytetarëve, si dhe të plotësojë zbrazëtitë në mes të problemeve dhe zgjidhjeve.

www.institutigap.org

Rr. Sejdi Kryeziu, Blloku 4, Nr.4,
10000 Prishtine

+383 38 609 339

info@institutigap.org

